




**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURENCËS  
KOMISIONI I KONKURENCËS**



*100 Vjet Pavarësi*

---

**VENDIM**

Nr.258 , datë 21.12.2012

**“Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e telefonisë  
celulare me pakicë”**

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

- Lindita MILO (LATI) Kryetar
- Rezana KONOMI Zv/Kryetar
- Servete GRUDA Anëtar
- Koço BROKA Anëtar
- Iva ZAJMI Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 21.12.2012, me pjesëmarrjen e Znj. L. Lati (Milo), Znj. R. Konomi, Znj. S. Gruda dhe I. Zajmi, trajtoi çështjen me:

**Objekt:** Shqyrtimin e propozimit të Sekretariatit për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e telefonisë celulare me pakicë.

**Baza ligjore:** Nenet 24, shkronja d), neni 26 dhe neni 42, pika 1, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

**Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:**

- Raportit të Drejtorisë së Mbikëqyrjes dhe Hetimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike, Procedurave dhe Hetimit;
- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm “Mbi propozimin për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e telefonisë celulare me pakicë me parapagim”;

**VËREN SE:**

Tregu i telefonisë celulare është një nga tregjet kryesorë që ndikon në zhvillimin e ekonomisë në tërësi. Autoriteti i Konkurrencës për mbikqyrjen e këtij tregu të rregulluar ka bashkëpunim në mënyrë të vazhdueshme me Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare për të siguruar funksionimin e konkurrencës së lirë dhe efektive.

Sipas dokumentit të AKEP "Tregues statistikore dhe financiare të tregut të komunikimeve elektronike për vitin 2011", rezulton se në tregun e telefonisë celulare janë gjeneruar gjithsej 39.2 miliardë lekë të ardhura nga 4 operatorët që ofrojnë shërbime të telefonisë celulare. Ky treg karakterizohet nga ndërmarrje me pozitë dominuese në tregun e shërbimeve të telefonisë së lëvizshme me pakicë.

Bazuar në informacionet e depozituara pranë Autoritetit të Konkurrencës, në këto treg kohë e fundit vihen re shenja sjelljeje potencialisht antikonkurrese të një/disa operatoreve, që mund të kenë si qëllim dhe/ose pasoje kufizimin e konkurrencës së lire dhe efektive.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 24, shkronja d, si dhe nenit 42, pika 1, të Ligjit Nr .9121, datë 28.7.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", me propozim të Sekretariatit,

### **V E N D O S I:**

- I. Hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e telefonisë celulare me pakicë me parapagesë.
- II. Periudha e hetimit do të jetë nga Janari 2012 deri në Nëntor 2012.
- III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për ndjekjen e procedurave hetimore të parashikuara në Ligj dhe aktet nënligjore përkatëse, si dhe përgatitjen e raportit të hetimit paraprak jo më vonë se data 31. 01.2013.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**Servete GRUDA**

( \_\_\_\_\_ )  
**Anëtar**

**Koço BROKA**

( \_\_\_\_\_ )  
**Anëtar**

**Iva ZAJMI**

( \_\_\_\_\_ )  
**Anëtar**

**Rezana KONOMI**

( \_\_\_\_\_ )  
**Zv/Kryetar**

**Lindita MILO (LATI)**

\_\_\_\_\_  
**K R Y E T A R**